



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 3468 Prot.
16

Pogradec, më 30 . 08 .2024

VENDIM

Nr. 97, DATË 28 / 08 /2024

“MBI TË DREJTAT E PËRDORIMIT TË AMBIENTEVE SPORTIVE NGA
SHOQËRISA “POGRADECI F.K” SHA

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të nenit 25, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, të Ligjit nr.7850, datë 29.07. 1994 "Kodi Civil i RSH-së", i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Finacave Nr.30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec (VKB) Nr. 46, datë 24.04.2024 si dhe Kontratës së Ankandit Publik e datës 31.07.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë draftin e e Akt-marrëveshjes “Mbi Të Drejtat E Përdorimit Të Ambienteve Sportive Nga Shoqëria “Pogradeci F.K” Sha”, sipas lidhjes bashkangjitur.
2. Të Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për lidhjen e kësaj Akt-marrëveshjeje me Investitorin e shoqërisë “Pogradeci F.K” SHA.
3. Afati i dhënies në përdorim të ambienteve sportive (asetet dhe mallrat), në pronësi të Bashkisë Pogradec, për një kohë të pacaktuar, lidhet ngushtësisht me të drejtën që zotëron investitori ,si mbajtës i emrit të ekipit “POGRADECI F.K.”
4. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

Bulevardi “Rreshit Çollaku”, Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradeci@gmail.com



[Signature]

5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 22 vota

2. Vota Pro 22

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 30.08.2024

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M03707601D			
2. Data e Regjistrimit	07/01/2020			
3. Emri i Subjektit	K.F POGRADECI			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	01/03/2019			
6. Kohëzgjatja	Nga: 01/03/2019 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Korce Pogradec POGRADEC Pogradec prane stadiumit Gjorgji Kyçyku Pogradec me kod postar 7301			
8. Kapitali	3.500.000,00			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	3500000.0000			
10. Numri i aksioneve:	350,00			
10.1 Vlera nominale:	10.000,00			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori	350			
12. Objekti i aktivitetit:	-Organizimin e aktiviteteve ne fushen e sportit te futbollit dhe pjesmarjen ne garat sportive te organizuara nga Federata Sportive e Futbollit,si dhe pjesmarjen ne garat sportive te organizuara nga UEFA.-Krijimin e ekipeve zinxhir te futbollit.-Kryerjen e te gjitha veprimeve te nevojshme per aritjen e qellimit te shoqerise duke perfshire leshimin e dorezanive e garancive te tjera.-Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme shqiptare apo te huaja qe kane objekt te njejte apo te parafert me te kesaj shoqerie			
13. Sistemi i administrimit	<input checked="" type="checkbox"/> me një nivel <input type="checkbox"/> me dy nivele			



[Signature]

14. Administratori/ët	Nesti Binishi	
14.1 Afati i emërimit	Nga : 15/08/2022	Deri : 15/08/2025
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).		
16. Anëtarët e Këshillit të Administrimit (plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)	Enton Berberi	
16.1 Kryetar/anëtar	Kryetar	
16.2 Afati i emërimit	Nga : 19/03/2024	Deri : 18/03/2027
17. Anëtar i Pavarur	Po	
17.1 Përfaqësues i Punëmarrësve		
17.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
19. Anëtarët e Këshillit të Administrimit (plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)	Ilija Mani	
19.1 Kryetar/anëtar	Anëtar	
19.2 Afati i emërimit	Nga : 30/11/2023	Deri : 29/11/2026
20. Anëtar i Pavarur	Po	
20.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Po	
20.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
22. Anëtarët e Këshillit të Administrimit (plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)	Irsa Karapança	
22.1 Kryetar/anëtar	Anëtar	
22.2 Afati i emërimit	Nga : 30/11/2023	Deri : 29/11/2026
23. Anëtar i Pavarur	Po	
23.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Po	
23.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
25. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	Arber Gjata	
25.1 Afati i emërimit	Nga : 01/03/2019	Deri : 01/03/2022
26. Aksionarët	ARMAAR GROUP	
26.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote	: 350.0000
	Pa te drejte vote	:



Handwritten signature

26.2 Përqindja e pjesëmarrjes	100,00
27. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
28. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: K.F POGRADECI E-Mail: info@armaar.al Telefon: 0692073314
29. Statusi:	Aktiv

Datë :30/08/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga



Handwritten signature

AKT - MARRËVESHJE

MBI TË DREJTAT E PËRDORIMIT TË AMBIENTEVE SPORTIVE NGA SHOQËRIA "POGRADECI F.K" SHA

Kjo akt marrëveshje, lidhet sot, më datë ____ . ____ .2024, me vullnetin e lirë të palëve, si më poshtë,

Pala nr.1: BASHKIA POGRADEC, person juridik publik, me numër unik identifikimi të subjektit K44802605R, me adresë Pogradec, Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagjja Nr. 2 , përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec, z. Ilir XHAKOLLI, atësia Telha, amësia Senaber, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Pogradec, me adresë Rruga "10 Dëshmorët e Pojskës" , lindur në 25/09/1962, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Nr. personal G20925210Q, e njohur më poshtë si Pronari I ambienteve sportive, për të cilat caktohen kushtet e përdorimit,

Pala nr.2: Shoqëria "K.F. Pogradeci" SHA, e organizuar si Shoqëri Aksionare, me numër unik identifikimi të subjektit M03707601D, me adresë Korce Pogradec POGRADEC Pogradec prane stadiumit Gjorgji Kyçyku Pogradec me kod postar 7301, me administrator z. Nesti Binishi, atësia Petraq, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Pogradec dhe banues në Pogradec, me adresë Rr: "Lagjja 5, Rruga : Jani Basho, Pogradec, lindur më 21.04.1972, gjendja civile "I martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me numer personal H20421080V, referuar për efekt të kësaj kontrate si Përdoruesi.

Bashkia POGRADEC, në zbatim të Kontratës publike të Shitjes me Ankand të Aksioneve të Klubit të Futbollit "Pogradeci F.K" sha në masën 100%" shoqërisë "ARMAAR GROUP" shpk, me numër NIPT: M01517007J, harton këtë Akt Marrëveshje, për të përcaktuar të drejtat dhe kushtet e përdorimit të ambienteve sportive, nga ana e "K.F. Pogradeci" SHA, me qëllim përmbushjen e funksioneve të tij, në kuadër të zhvillimit të aktivitetit futbollistik në Qytetin e Pogradecit.

Neni 1 Baza Ligjore

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
Ligji nr.7850, datë 29.07. 1994 "Kodi Civil i RSH-së", i ndryshuar
Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"
Manuali I FSHF per mirembajtjen e ambienteve sportive
Kontrata e Ankandit Publik e datës 31.07.2024



Handwritten signature

Neni 2 Objekti

2.1 Në këtë akt-marrëveshje, njëra palë (Bashkia Pogradec - Pronari) i jep palës tjetër ("K.F. POGRADECI" shpk - Përdoruesit), pa kundërshtim, në plotësim të detyrimit që ka Bashkia Pogradec, në mbështetje të Ligjit 139/2015 për mbështetjen e aktiviteteve sportive futbollistike, të drejtën që të përdorë ambientet sportive (asetet dhe makineritë), në pronësi të Bashkisë Pogradec, për aq kohë sa është zotëruesi i emrit të ekipit "F.K. Pogradeci", sipas Relacionit së datës 30.07.2024, asetet si më poshtë:

- Terrenet sportive, Sheshi funksional, Ambientet ndihmëse, me zonë Kadastrale ZK. 8581/DSE5, Nr. Pasurie 1/134, vol. 15, fq. 240, nr. Inventari 1, sipas numrit rendor të pronave në listen e inventarit të VKM- së Nr.1240, datë 10.9.2008 dhe ze një sipërfaqe prej 17698.3 m² truall, ku 342.5 m² e të cilit është sipërfaqe ndërtimi. Vlera fillestare e këtij aseti ka qënë 968 223 lek, kurse vlera aktuale sot është 39 771 487 lek, pasi në vite Bashkia ka investuar në këtë aset.
- Aneksi i stadiumit të futbollit "Gjorgji Kyçyku" ndodhet në zonën kadastrale 8581 me nr pas 6/2, vol 15, faqe 117, me numër inventari 2, sipas numrit rendor të pronave në listën e inventarit të VKM- së Nr.1240, datë 10.9.2008 dhe ze një sipërfaqe prej 8451.3 m² truall, dhe ka një vlerë fillestare 785354 lek.
- Makineri, si më poshtë:
 - ✓ Autobus, cope 1 (nje), ne shumën 3 828 000 (tre million e tetëqind e njëzet e tetë mijë) lekë,
 - ✓ Traktor për korje bari, copë 1 (një), në shumën 330 000 (treqind e tridhjetë) mijë lekë.

2.2 T'i jepet në përdorim administratorit të "K.F. Pogradeci" SHA, inventari i imet sipas relacionit së datës 30.07.2024, bashkëngjitur kësaj akt-marrëveshje.

Neni 3 Afati

3.1 Kjo Akt - Marrëveshje quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

3.2 Shoqëria "K.F. Pogradeci" SHA do të përdorë ambientet sportive (asetet dhe mallrat), në pronësi të Bashkisë Pogradec, për një kohë të pacaktuar, e cila lidhet ngushtësisht me të drejtën që zoteron si mbajtës i emrit të ekipit "K.F. Pogradeci".

3.3 Në rast se konstatohet se aksioneri / aksioneret e "K.F. Pogradeci" sha, kane shkelur detyrimet e përcaktuara në kontratën e shitjes me Ankand të aksioneve të "K.F. Pogradeci".



Handwritten signature

F. POGRADECI.” sha, pronari krahas heqjes së përdorimit të emrit të ekipit, ka të drejtën të heqë edhe përdorimin e ambienteve të stadiumit, me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e Pronarit

4.1 Në rast se pronarit, i lind nevoja për organizimin e aktiviteteve sportive – kulturore – artistike, pa cënuar aktivitetin futbollistik dhe pa dëmtuar gjendjen e terreneve sportive, Bashkia bën Njoftim Paraprak tek përdoruesi mbi organizimin e këtyre aktiviteteve.

4.2 Sendi, në momentin e lidhjes së kësaj Akt – Marrëveshje është dorëzuar në gjendje të mirë, i certifikuar nga FSHF, sipas standadeve në fuqi mbi Rregulloren e Infrastrukturës.

4.3 Bashkia ka të drejtë të informohet për çdo ndryshim, që shoqëria kërkon të realizojë apo të ndërhyjë tek sendi si dhe të japë miratim me shkrim për çdo ndryshim apo investim në terrenet sportive, duke iu referuar legjislacionit në fuqi.

4.4 Pronari nuk detyrohet të paguajë asnjë investim apo shtim të vlerës së sendit për mirëmbajtjen e zakonshme, që përdoruesi do të kryejë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj akt-marrëveshje.

4.5 Në qoftë se Pronari gjatë zbatimit të kësaj akt-marrëveshje ndodhet përpara një nevoje të ngutshme dhe të paparashikueshme në momentin e lidhjes së saj, si rrjedhojë e situatave të emergjencës të shkaktuara nga forca madhore ose si rrjedhojë e ndryshimit të legjislacionit, rregullave, normave apo standardeve, pronari mund të kërkojë pezullimin ose zgjidhjen e akt marrëveshjes, në varësi të shkakut të paparashikuar dhe kohëzgjatjes së tij, Në keto raste përdoruesit nuk i lind e drejta të kërkojë dëmshpërblim.

Neni 5

Të Drejtat dhe Detyrimet e Përdoruesit

5.1 Përdoruesi, detyrohet ta mbajë dhe ta ruajë sendin me përkujdesje. Ai nuk mund ta përdorë atë ndryshe nga përdorimi i caktuar në këtë akt-marrëveshje ose nga natyra e sendit.

5.2 Përdoruesi, nuk mund t’ia japë një të treti sendin për përdorim pa pëlqimin e Pronarit.

5.3 Përdoruesi, është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e sendit, përveç kur provon se humbja ose dëmtimi i sendit do të kishte ndodhur edhe në rast se do të ishte në dorëzim të pronarit.



Handwritten signature

5.4 Në qoftë se përdoruesi e përdor sendin ndryshe nga sa është caktuar në këtë akt-marrëveshje ose nga natyra e tij dhe për një kohë më të gjatë se sa duhej, përgjigjet për humbjen e ndodhur edhe nga rasti faktor, përveç kur provon se sendi do të humbiste njëlloj, si të mos përdorej ndryshe, si të ishte kthyer në kohën e caktuar në këtë akt-marrëveshje.

5.5 Përdoruesi nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë për të përdorur sendin.

5.6 Kur përdoruesi nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura Pronari mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit, përveç shpërblimit të dëmit.

5.7 Përdoruesi, ka të drejtën e përdorimit të ambienteve, duke u kushtëzuar, si më poshtë:

- Përdorimi i ambienteve të stadiumit, fushave stërvitore dhe ambienteve ndihmëse duke kushtëzuar të drejtën e përdorimit mbi to, vetëm në funksion të veprimtarisë futbolistike ose aktivitete të tjera gjithmonë në funksion të futbollit.
- Ambientet e stadiumit të qytetit, në pronësi të Bashkisë Pogradec, të përdoren dhe të mirembahen nga përdoruesi i cili do të zotërojë aksionet e "POGRADECI F.K." sh.a., pa vlerë qeraje.
- Të paguhen gjithë detyrimet për furnizim me energji, uje etj, të nevojshme për mirëfunksionimin e ambienteve.
- Të mirëmbajë, terrenet sportive (fushat e barit, fushat stërvitore), të cilat të jenë në gjendje optimale për të shërbyer për qëllimin që janë krijuar, Sipas Rregullores së Federatës Shqiptare të Futbollit, të hartuara në mbështetje të standarteve të "Bordi I Federatës Ndërkombëtare të Futbollit" (IFAB).
- Të respektojë cdo të drejtë ose detyrim mbi ambientet e stadiumit apo territoret ndihmëse, të krijuar përpara realizimit të shitjes së aksioneve të KF Pogradeci sh.a.
- Per cdo ndërhyrje apo investim që do realizojë, duhet të njoftojë më parë Bashkinë Pogradec, e cila do ti japë miratimin me shkrim për investimin apo ndërhyrjen, sipas legjislacionit në fuqi, gjithnjë me qëllim të përmirësimit të këtyre aseteve në funksion në aktivitetit futbolistik.

5.8 Në rast të falimentimit të përdoruesit, shoqërisë "POGRADECI F.K" sha, pronari Bashkia Pogradec, mund të kërkojë nga shoqëria kthimin e menjëhershëm të sendit.

5.9 Përdoruesi është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e zakonshme dhe mirembajtjen e ambienteve.

5.10 Përdoruesi është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e jashtëzakonshme të sendit të dhënë në përdorim, te cilat kur kryhen në formën e investimit duhet të kenë miratimin paraprak të Bashkisë Pogradec.



5.11 Mirembajtjet e zakonshme duhet te kryhen gjithmone ne kushtet e percaktuara nga FSHF. Plotesimi i ketyre kushteve vertetohet nepermjet certifikimit vjetor qe ben federata, te cilin duhet ta paraqese ne Bashki.

PALET KONTRAKTUESE

PRONARI

BASHKIA POGRADEC

(Përfaqësuar Nga Titullari)

Z. Ilir XHAKOLLI

PËRDORUESI

Shoqëria "POGRADECI F.K." SHA

(Përfaqësuar nga Administratori)

Z. Nesti BINISHI

